



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



**KRYETARI I KRYEQYTETIT**

14-020/04-58506/24, më 07 MAY 2024

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë

**V E N D I M**

- I. Plotësohet-ndryshohet vendimi me nr. 14-020/05-20903/24 i datës 06.02.2024 për caktimin e komisionit për vlerësimin e gjendjes fizike të disa objekteve të cilat menaxhohen nga Kryeqyteti.
- II. Anëtarët e komisionit të cekur në pikën I të këtij vendimi janë:
  1. Fatmir Bilalli, Drejtorja për Siguri dhe Emeregjenca, kryesues;
  2. Berim Osmani, Drejtorja e Urbanizmit;
  3. Vebi Lipa, Drejtorja e Inspektionit, anëtar; dhe
  4. Ferit Fazliu, Drejtorja e Urbanizmit, anëtar;
- III. Detyrat e komisionit të cekur në pikën II të këtij vendimi janë:
  - Përpilimi i një raporti për vlerësimin e strukturës, rrezikut potencial dhe intervenimeve eventuale lidhur me gjendjen e kulmit në ndërtesën e renovuar të Brigadës së Zjarrëfikësve;
  - Vlerësimi i rrezikut në disa nga ndërtesat e Kryeqytetit: shkolla, institucione parashkollore, qendra të mjekësisë familjare etj, me qëllim të evidentimit të rrezikut nga ndonjë avari e mundëshme, në koordinim me drejtuesit e këtyre institucioneve. Përzgjedhja e ndërtesave duhet të bëhet nga Komisioni sipas kërkesave dhe njoftimeve për rrezikun eventual.
- IV. Të gjitha sektorët e Komunës së Prishtinës janë të obliguar që të bashkëpunojnë ngushtë me komisionin dhe t'ju ofrojnë dokumentet e kërkuara lidhur me vlerësimin e rrezikut të ndërtesave sipas këtij vendimi.
- V. Për kryerjen e detyrave si në pikën III të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Kryeqytetit.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

**I D O R Ë Z O H E T:**

- Anëtarëve të komisionit;
- Qendrës për shërbime me qytetar;
- Në dosje.

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**  
Përparim Rama

